

VENDIM
Nr. 212, datë 15.12.2020

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR. 266, DATË 21.12.2018

Në mbështetje të: i. nenit 16; ii. nenit 19, germa “c”, pika “i”; iii. nenit 20, germa “c”; iv. nenit 21; dhe v. nenit 55, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Enti Rregullator i Energjisë (ERE) nr. 180, datë 8.11.2017, si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “c”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 132/8 prot., datë 11.12.2020, të Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018,

konstatoi se:

- Shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST sh.a.) me shkresën nr. 5686 prot., datë 24.9.2020, ka paraqitur kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021, sipas materialit që OST sh.a. i ka bashkëngjitur kësaj shkrese.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 163, datë 22.10.2020, ka vendosur mosfillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021.

- Në vijim, shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 6731, datë 9.11.2020, ka paraqitur një kërkesë për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 163, datë 22.10.2020, “Mbi aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 206, datë 11.12.2020, ka miratuar rrëzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 163, datë 22.10.2020, “Mbi mosfillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., lidhur me miratimin e tarifës së kërkuar prej 1.31 lekë/kwh, për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021”.

- Në vijim të sa më sipër evidentuar, dhe në kushtet kur:

- aplikimi i paraqitur nga shoqëria OST sh.a., për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021, është refuzuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 163, datë 22.10.2020;

- kërkesa për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 163, datë 22.10.2020, “Mbi mosfillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., lidhur me miratimin e tarifës së kërkuar prej 1.31 lekë/kwh, për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021”, është refuzuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 206, datë 11.12.2020;

- në mënyrë që shoqëria OST sh.a. të mund të vijojë realizimin e aktivitetit të saj dhe përgjatë vitit 2021, sipas kushteve të licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, të lëshuar në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhet e domosdoshme që shoqëria të vijojë faturimin bazuar në tarifën e transmetimit të miratuar nga ERE;

- në vlerësimet e ERE-s, llogaritet se tarifa aktuale e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike i ka krijuar shoqërisë OST sh.a. rezerva të ardhurash të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative, ku përfshihet dhe prokurimi i shërbimeve ndihmëse në tregun e lirë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, deri në aplikimin për përcaktimin e tarifave të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a., në përputhje me kërkesat e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë OST sh.a., tarifa mesatare e transmetimit do të axhustohet/korrigjohet në zbatim të përcaktimeve të pikës 7, të nenit 11, të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga data 1.1.2021.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti